



Clingendael

Instituti Holandez i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Ministria e Punëve të Jashtme- Ministarstvo Inostranih Poslova- Ministry of Foreign Affairs

Akademia Diplomatike-Diplomatska Akademija-Diplomatic Academy

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

MES

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

AKADEMISË CLINGENDAEL¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Instituti Holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael", (këtu e tutje referuar si "Palët"), duke dashur që të vendosin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në lidhje me hulumtime të përbashkëta dhe trajnimin e stafit diplomatik, kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është të krijojë strukturën e bashkëpunimit mes palëve.

Neni 2

Bashkëpunimi

Prioritetet e këtij bashkëpunimi janë:

1. Trajnimi profesional dhe përmirësimi i kualifikimit të diplomatëve në fushën e:
2. Politikës së jashtme

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

-)
3. Marrëdhëniet ndërkombëtare
 4. Integritet Evropian
 5. Diplomacisë ekonomike
 6. Sigurisë ndërkombëtare dhe menaxhimit të konfliktit
 7. Negociatave ndërkombëtare
 8. Ngritjes së kapaciteteve në trajnimin diplomatik
 9. Shkëmbimit reciprok të informatave mbi çështjet arsimore, metodologjike dhe shkencore.

Neni 3

Zbatimi

Palët do të realizojnë bashkëpunimin nëpërmjet:

1. Programeve të kurseve themelore dhe të specializuara të trajnimit;
2. Shkëmbimit të diplomatëve, ligjëruesve dhe studiuesve / ekspertëve;
3. Shkëmbimit të përvojave mbi aktivitetet përkatëse arsimore dhe çështjeve të metodologjisë mësimore
4. Realizimit të projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët;
5. Pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume dhe diskutim në panele në vendin e njëri-tjetrit;
6. Bashkëpunimit në përgatitjen e kualifikimit, punës akademike dhe të disertacionit
7. Shkëmbimit të burimeve arsimore, librave, botimeve dhe artikujve

Neni 4

Kushtet financiare

Format, kohëzgjatjet dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të palëve nënshkruesve do të dakordohen ndërmjet palëve nënshkruesve.

)

Neni 5

Komunikimi

Palët do të informojnë njëra-tjetrën për organizimin e ligjëratave dhe fjalimeve dhe ngjarjeve tjera relevante.

Akademia e Republikës së Kosovës duhet të informohet me shkrim nga Akademia Clingendael për çdo ngjarje, ligjëratë apo fjalim të organizuar lidhur me Kosovën dhe Diplomacinë rajonale,

Neni 6

Amandamentimi

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve përmes konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen me pëlqimin reciprok me shkrim të palëve.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet valid, përveç nëse njëra Palë njofton tjetrën me shkrim për qëllimin e saj për të shfuqizuar këtë memorandum, të paktën tre muaj paraprakisht.

NË DËSHMI TË KËSAJ, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrë të duhur, kanë nënshkruar këtë memorandum.

NËNSHKRUAR në Prishtinë, me 5 shtator 2013, në dy kopje në gjuhën angleze.

Pjesë përbërëse e këtij Memorandumi është shtojca I e bashkangjitur.

Për Akademinë Diplomatike

Për Clingendael

Republika e Kosovës

Instituti Holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare

Albert Prenkaj, Ambasador

Ron Ton, Drejtor

Shtojca 1

- I. Trajnimi në lidhje me temat profesionale do të ofrohet nga Clingendael në Hagë, seminarët dhe trajnimet për ngritjen e kapaciteteve do të organizohen në Akademinë Diplomatike të Kosovës, nga ana e Clingendael.
2. Palët janë dakorduar të realizojnë kurset e mëposhtme, të cilat do të organizohen nga Akademia Clingendael në Hagë. Sfera financiare e kurseve do të mbulohet nga Akademia Diplomatike e Kosovës.
 - 2.1 Kurse për diplomatë të rinj - 4 javë;
 - 2.2 Kurse për diplomatë të nivelit të mesëm- 3 javë;
 - 2.3 Kurse për diplomatë të nivelit të lartë- 2 javë;
3. Secili kurs do të organizohet një herë në vit për periudhën 2014-2016
4. Specialistët e Akademisë Clingendeal do t'i trajnojnë kandidatët diplomatikë të Kosovës mbi ngritjen e kapaciteteve në Kosovë. Sfera financiare e kurseve do të mbulohet nga Akademia Diplomatike e Kosovës.